**Pasqyrat Financiare të Shoqërisë:**

**NOVA CONSTRUCTION 2012 SHPK**

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**
**se bashku me Raportin e Audituesit te Pavarur**

# Permbajtja

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR ..... 3
BILANCI I GJENDJES FINANCIARE ..... 4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES ..... 5
PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASE ..... 6
PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE TE VETA ..... 7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE ..... 8
1. Informacione të përgjithshme ..... 8
2. Bazat e përgatitjes ..... 8
3. Politikat kryesore kontabël ..... 9
A.1 Mjetet monetare ..... 12
A.2 Klientet ..... 12
A.3 Inventari ..... 12
A.4 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra ..... 12
A.5 Aktivet afatgjata materiale ..... 13
A.6 Aktive afatgjata financiare ..... 13
B.1 Llogari te pagueshme tregtare ..... 14
B.2 Detyrimet tatimore ..... 14
B.3 Detyrime ndaj ortakeve ..... 14
B.4 Hua te marra ..... 14
C.1 Te ardhurat ..... 15
C.2 Materialet e konsumuara dhe sherbimet ..... 15
C.3 Kostot e punes ..... 15
C.4 Shpenzime te tjera operacionale ..... 15
C.6 Tatimi mbi fitimin ..... 16

**RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR**

**Për Administratoret dhe Asamblene e NOVA CONSTRUCTION 2012 SHPK**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqerise NOVA CONSTRUCTION 2012 (në vijim referuar si "Shoqeria") bashkëlidhur të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e flukseve rrjedhëse të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këte datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndesishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

**Përgjegjesia e Drejtimit për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e vërtetë dhe të sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjin Nr. 9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe për kontrollet e brendshme në masën që drejtimi i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë pasaktësi materiale, si pasojë e gabimeve apo mashtrimeve.

**Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojne që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të përftuar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me vlerat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të pasaktësive materiale të pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të përshtatshem për përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare të Shoqërisë me qëllim që të planifikojë procedura auditimi që përshtaten me rrethanat, por jo me qëllim per të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura si dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë të auditimit.

**Opinioni**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në te gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqerise NOVA CONSTRUCTION 2012 më datën 31 Dhjetor 2014, si edhe performancën e saj financiare dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit me Shqiperi.

Sokol Toska

OPERA AUDITORS

28 Maj 2015

OPERA SH.P.K. K 92229009 Q — Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit, Komp. Green Park Kulla 1, Ap. 19, Tirane - Albania

OPERA
Auditors & Appraisers

OPERA AUDITORS SHPK – an independent audit firm
Rruga Abdyl Frasheri, Nr. 16/1, Tirana 1019, Albania
+355 662021233 • e-mail: contact@opera.al • K92229009Q

# BILANCI I GJENDJES FINANCIARE
Me 31 Dhjetor 2014

| | Shënime | 2014 | 2013 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| Mjete monetare | A.1 | 1,039,805 | 44,923 |
| Kliente | A.2 | 121,462,192 | 180,036,064 |
| Inventar | A.3 | 13,914,268 | 4,593,378 |
| Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | A.4 | 12,600,000 | 0 |
| **Aktive Afatshkurtra** | | **149,016,265** | **184,674,364** |
| Aktive afatgjata materiale | A.5 | 5,922,500 | 4,784,222 |
| Aktive financiare | A.6 | 40,696,980 | 0 |
| **Aktive Afatgjata** | | **46,619,480** | **4,784,222** |
| **TOTAL AKTIVE** | | **195,635,745** | **189,458,586** |
| **DETYRIMET** | | | |
| Furnitore | B.1 | 170,305,409 | 163,267,169 |
| Detyrime ndaj punonjesve | | 272,188 | 92,000 |
| Detyrime tatimore | B.2 | 1,189,975 | 1,211,479 |
| Detyrime ndaj ortakeve | B.3 | 0 | 16,933,475 |
| Hua te marra | B.4 | 7,457,000 | 0 |
| **Detyrimet Afatshkurtra** | | **179,224,572** | **181,504,123** |
| **TOTAL DETYRIME** | | **179,224,572** | **181,504,123** |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali ligjor | | 100,000 | 100,000 |
| Rezultate te mbartura | | 7,854,463 | 0 |
| Rezultate te periudhes | | 8,456,710 | 7,854,463 |
| **Kapitali dhe fondet e veta** | | **16,411,173** | **7,954,463** |
| **TOTAL DETYRIMET DHE KAPITALI** | | **195,635,745** | **189,458,586** |

Ilir Shtufi
Administrator

NIPT L 22404012 D
NOVA CO 2012
TIRANE - ALBANIA

Arti Larti
Kontabilist

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.*

# PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

| | Shënime | 2014 | 2013 |
|---|---|---|---|
| Shitje punime dhe shërbime | C.1 | 156,382,092 | 172,284,003 |
| **TOTALI I TE ARDHURAVE** | | **156,382,092** | **172,284,003** |
| Materialet e konsumuara dhe sherbimet | C.2 | -137,021,829 | -161,901,330 |
| Kostot e punës | C.3 | -1,967,724 | -1,271,956 |
| Amortizimi dhe zhvleresimi | A.5 | -1,452,826 | -252,444 |
| Shpenzime të tjera operacionale | C.4 | -5,962,051 | -129,721 |
| **TOTALI I SHPENZIMEVE** | | **-146,404,430** | **-163,555,451** |
| **REZULTATI NGA VEPRIMTARIA KRYESORE** | | **9,977,662** | **8,728,552** |
| Te ardhura dhe shpenzime financiare | C.5 | 0 | -1,371 |
| **REZULTATI PARA TATIMIT** | | **9,977,662** | **8,727,181** |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | C.6 | -1,520,952 | -872,718 |
| **FITIMI NETO I PERIUDHES** | | **8,456,710** | **7,854,463** |

Ilir Shtufi
ADMINISTRATOR

NIPT L 22404012 D
NOVA CO
2012
TIRANE - ALBANIA

Arfi Larti
Kontabilist

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.*

# PASQYRA E FLUKSEVE TE PARASE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

| **Pasqyra e fluksit monetar** | **2014** | **2013** |
|---|---|---|
| Mjetet monetare të arkëtuara nga klientët | 246,232,382 | 26,704,740 |
| MM të paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve | -208,915,510 | -38,516,540 |
| Interes i paguar | 0 | 0 |
| Tatim Fitimi i paguar | -490,905 | -40,000 |
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | **36,825,967** | **-11,851,800** |
| Blerja e Aktiveve Afatgjata Materiale | -2,591,104 | -5,036,666 |
| Te ardhura nga huadhenia | -40,696,980 | 0 |
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese** | **-43,288,084** | **-5,036,666** |
| Te ardhura nga emetimi kapitalit | 0 | 0 |
| Huadhenie afatgjata | 7,457,000 | 16,933,475 |
| **Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | **7,457,000** | **16,933,475** |
| **Rritja neto e mjeteve monetare** | **994,883** | **45,009** |
| **Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël** | **44,923** | **0** |
| **Diferenca kursi** | **0** | **-86** |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël** | **1,039,805** | **44,923** |

Ilir Shtufi
ADMINISTRATOR

NIPT L 22404012 D
NOVA CO
2012
TIRANE - ALBANIA

Arti Larti
Kontabilist

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.*

# PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE TE VETA
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

| | Kapitali aksionar | Fitimi i periudhes | TOTAL |
|---|---|---|---|
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2011** | **0** | **0** | **0** |
| Fitimi neto për periudhën | 0 | 0 | 0 |
| Emetim i kapitalit | 100,000 | 0 | 100,000 |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2012** | **100,000** | **0** | **100,000** |
| Fitimi neto për periudhën | 0 | 7,854,463 | 7,854,463 |
| Emetim i kapitalit | 0 | 0 | 0 |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2013** | **100,000** | **7,854,463** | **7,954,463** |
| Fitimi neto për periudhën | 0 | 8,456,710 | 8,456,710 |
| Emetim i kapitalit | 0 | 0 | 0 |
| **Pozicioni më 31 Dhjetor 2014** | **100,000** | **16,311,173** | **16,411,173** |

Ilir Shtufi
ADMINISTRATOR

Arli Larti
Kontabilist

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.*

# SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

## 1. Informacione të përgjithshme

NOVA CONSTRUCTION 2012 është një shoqeri, e themeluar dhe regjistruar më 3 Dhjetor 2012 dhe organizohet në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare në Shqipëri.

Objekti kryesor i aktivitetit është në fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1/e-planvendosje e objekteve te vecanta, kat. 2/a, projektime dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b-projektime dhe ndertime civile industriale, turistik e, bujqesore etj.

Njësiaështe aktive dhe ka zhvilluar aktivitete qe prej themelimit dhe është regjistruar me numër unik L22404012D.

Më 31 Dhjetor 2014 njesia ka 7 të punësuar me kontrata pune.

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë është e përbërë nga:

1. Z. Ilir Shtufi zotërues i 51 përqind të kuotave të kapitalit.
2. Z. Kujtim Shtufi zotërues i 49 përqind të kuotave të kapitalit.

Administrator i Shoqërisë është zoti. Ilir Shtufi.

Selia e njesise eshte ne Rr. Durresit, Nr 111, Tiranë.

## 2. Bazat e përgatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura te shoqerise NOVA CONSTRUCTION 2012 jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e kerkuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekononike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur ne vijim.

## 3. Politikat kryesore kontabël

### i. Instrumentat financiare

Shoqeria NOVA CONSTRUCTION 2012 ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus cdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e njesise te specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anullohen.

*Mjetet Monetare*

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

*Detyrime te pagueshme*

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

### ii. Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesat dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbritese.

Normat e amortizimit te perdorura paraqiten si vijon:

| ***Pershkrimi*** | ***Norma e Amortizimit*** |
|---|---|
| *Pajisje makineri* | *20 %* |
| *Mjete transporti* | *20 %* |

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

### iii. Kapitali, fondet e veta

Aksionet e neshkruara nga ortaket dhe aksionaret njohen si kapital.

# 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

## iv. Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te njesise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktivi eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normene skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percacktimin e vleres se rekuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anullohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

## v. Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive fianciare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne gurpe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anullohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anullimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

## vi. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte te përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t’u marrë nga shitja e mallrave dhe sherbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Njesise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

## 3. Politikat kryesore kontabël (vazhdim)

### vii. Inventari

Inventare njihen me me te voglen mes kostos dhe vleres neto te realizueshme.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus kostot e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe perfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit te tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

### viii. Shpenzimet

*Pagesat per qerate*

Pagesat e kryera si qera e zakonshme njihen ne shpenzime te periudhes ne baze lineare duke u mbeshtetur ne kushtet e qerase.

*Shpenzimet*

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

### ix. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

### x. Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

| | *31 Dhjetor 2014* | *31 Dhjetor 2013* |
|---|---|---|
| 1 EUR | 140.14 | 140.20 |
| 1 USD | 115.23 | 101.86 |

## A.1 Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Llogari rrjedhese bankare | 122,805 | 44,923 |
| Mjete monetare cash ne arke | 917,000 | 0 |
| **TOTAL** | **1,039,805** | **44,923** |

## A.2 Klientet

Gjendja e klienteve ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Kliente per punime ndertimore | 117,982,192 | 180,036,064 |
| Kliente te tjere | 3,480,000 | 0 |
| **TOTAL** | **121,462,192** | **180,036,064** |

## A.3 Inventari

Gjendja e inventarit ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Inventar | 11,682,038 | 4,593,378 |
| Parapagime furnitore per inventar | 2,232,230 | 0 |
| **TOTAL** | **13,914,268** | **4,593,378** |

## A.4 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Gjendja e parapagimeve ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Parapagime kontraktuale | 12,600,000 | 0 |
| **TOTAL** | **12,600,000** | **0** |

(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

## A.5 Aktivet afatgjata materiale

Paraqiten aktivet afatgjata ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

**Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2014**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 01/01/2014 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 5,000,000 | 6,382,100 | 4,865,000 | **6,517,100** |
| 2 | Kompjuterike | | 0 | 471,270 | 0 | **471,270** |
| 3 | Zyre | | 36,667 | 197,317 | 0 | **233,984** |
| | ***TOTALI*** | | ***5,036,667*** | ***7,050,687*** | ***4,865,000*** | ***7,222,354*** |

**Amortizimi A.A.Materiale 2014**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 01/01/2014 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 250,000 | 1,431,267 | 405,417 | **1,275,850** |
| 2 | Kompjuterike | | 0 | 9,818 | 0 | **9,818** |
| 3 | Zyre | | 2,444 | 11,741 | 0 | **14,185** |
| | ***TOTALI*** | | ***252,444*** | ***1,452,826*** | ***405,417*** | ***1,299,853*** |

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2014**

| Nr | Emertimi | Sasia | Gjendje 01/01/2014 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjete transporti | | 4,750,000 | 6,382,100 | 6,701,684 | **5,241,250** |
| 2 | kompjuterike | | 0 | 471,270 | 9,818 | **461,452** |
| 3 | Zyre | | 34,222 | 197,317 | 11,741 | **219,798** |
| | ***TOTALI*** | | ***4,784,222*** | ***7,050,687*** | ***6,723,243*** | ***5,922,500*** |

## A.6 Aktive afatgjata financiare

Gjendja e aktiveve afatgjata financiare ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Financim afatgjate pale te lidhura | 40,696,980 | 0 |
| **TOTAL** | **40,696,980** | **0** |

## B.1 Llogari te pagueshme tregtare

Gjendja e furnitoreve ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Furnitore per punime ndertimore | 170,305,409 | 163,267,169 |
| **TOTAL** | **170,305,409** | **163,267,169** |

## B.2 Detyrimet tatimore

Gjendja e detyrimeve tatimore ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Sigurime shoqerore | 42,128 | 24,831 |
| Tatim mbi pagat TAP | 3,900 | 11,000 |
| Tatimi mbi fitimin | 1,030,047 | 832,718 |
| Tatimi mbi vleren e shtuar | 113,900 | 342,930 |
| **TOTAL** | **1,189,975** | **1,211,479** |

## B.3 Detyrime ndaj ortakeve

Gjendja e detyrimeve ndaj ortakeve ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Detyrime ndaj ortakeve | 0 | 16,933,475 |
| **TOTAL** | **0** | **16,933,475** |

## B.4 Hua te marra

Gjendja e huave te marra ne daten 31 Dhjetor 2014 paraqitet si vijon.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Huamarrje nga individe | 7,457,000 | 0 |
| **TOTAL** | **7,457,000** | **0** |

## C.1 Te ardhurat

Paraqiten te ardhurat e njohura per periudhen qe raportohet.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Shitje punime ndertimore | 153,482,092 | 172,284,003 |
| Shitje te tjera | 2,900,000 | 0 |
| **TOTAL** | **156,382,092** | **172,284,003** |

## C.2 Materialet e konsumuara dhe sherbimet

Paraqiten shpenzimet direkte te aktiviteteve ndertimore per periudhen qe raportohet.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Shpenzime materiale | 89,086,550 | 97,365,844 |
| Blerje te tjera | 0 | 750,317 |
| Punime te nenkontraktuara | 47,935,279 | 63,785,169 |
| **TOTAL** | **137,021,829** | **161,901,330** |

## C.3 Kostot e punes

Paraqiten kostot e punes per periudhen qe raportohet.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Pagat dhe shperblimet e personelit | 1,772,000 | 1,158,624 |
| Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | 195,724 | 113,332 |
| **TOTAL** | **1,967,724** | **1,271,956** |

## C.4 Shpenzime te tjera operacionale

Paraqiten shpenzimet e tjera operacionale per periudhen qe raportohet.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Vlera kont. e AQ te shitura | 4,459,583 | 0 |
| Transferime, udhetime, dieta | 700,000 | 0 |
| Shpz.postare e telekom. | 274,415 | 0 |
| Gjoba dhe demshperblime | 162,019 | 0 |
| Riparime makineri | 143,200 | 95,000 |
| Taksa Doganore | 123,369 | 0 |
| Personel jashte ndermarjes | 90,000 | 0 |
| Kancelari | 75,349 | 22,886 |
| Sherbime bankare | 50,097 | 11,836 |
| Taksa dhe tarifa vendore | 43,340 | 0 |
| Shpenzime te tjera | 19,167 | 0 |
| Siguracione | 16,150 | 0 |
| Fitime nga kembimet valutore | -194,638 | 0 |
| **TOTAL** | **5,962,051** | **129,721** |

## C.6 Tatimi mbi fitimin

Paraqitet tatami mbi fitimin per periudhen qe raportohet.

| | 2014 | 2013 |
|---|---|---|
| Rezultati financiar para tatimit | 9,977,662 | 8,727,181 |
| *Shtohen shpenzime te panjohura:* | | |
| Gjoba | 162,019 | 0 |
| **Rezultati Tatimor** | **10,139,681** | **8,727,181** |
| **Tatimi mbi fitimin 15 % (2010: 10%)** | **1,520,952** | **872,718** |
| **Tatimi mbi fitimin I parapaguar** | **490,905** | **40,000** |
| **Tatimi mbi fitimin per tu paguar** | **1,030,047** | **832,718** |